

### Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.



Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësit e institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

### Aktivitetet përgjatë muajit Prill, 2023

#### Komiteti Koordinator Antikorrupsion miraton Raportin e Monitorimit të Planit të Veprimit Antikorrupsion për vitin 2022

**19.04.2023:** Komiteti Koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit miratoi raportin e monitorimit vjetor 2022 të Planit të Veprimit Antikorrupsion. Raporti jep një vlerësim të detajuar mbi ecurinë e 18 objektivave specifike për parandalimin, ndëshkimin dhe ndërgjegjësimin kundër korrupsionit, për vitin e 8-të të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe vitin e 3-të të Planit të Veprimit, në fuqi. Raporti i monitorimit 2022 evidenton veprimet e organeve publike në luftën kundër korrupsionit referuar masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit dhe treguesve të performancës. Raporti vlerëson sektorët që kanë shënuar progres, si: transparencja e autoriteteve publike (100 autoritete të reja publike kanë instaluar e-regjistrer kërkesash dhe përgjigjesh); digjitalizimi i shërbimeve elektronike (janë 1227 e-shërbime në funksion të plotë), instrumentet e integritetit të administratës publike (të gjitha ministritë e linjës kanë miratuar plane integriteti), është ngritur dhe filluar nga përdorimi sistemi elektronik i deklarimit të pasurive dhe interesave privatë, është rritur bashkëpunimi dhe efica e organeve ligjzbatuese (SPAK-PP-Polici e Shtetit), është shtuar ndërgjegjësimi dhe bashkëpunimi me publikun kundër korrupsionit. Ndërkohë, u la detyrë, kontroll më i plotë për financat e partive politike, rritje kapacitetesh për audituesit publikë, ngritja e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve dhe më shumë bashkëpunim me OSHC-të. Ministria e Drejtësisë, si kryesues i Komitetit Koordinator, i kërkoi institucioneve publike që të vazhdojnë të bashkëpunojë dhe të ndihmojnë në luftën kundër korrupsionit, duke dhënë kontributin e tyre periodik në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike dhe në forcimin e besimit të qytetarëve. Takimi i Komitetit Koordinator u ndoq nga një pjesëmarrje e gjerë e përfaqësuesve të OSHC-ve aktive në vend dhe të organizatave të huaja.



Raporti i Monitorimit vjetor, 2022 mund të aksesohet në këtë link: <https://drejtesia.gov.al/viti-2022-2/>

#### Struktura antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë kallëzon penalisht dhe propozon masa disiplinore për raste korrupsioni

**01-28.04.2023:** Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në bashkëpunim me Rrjetin e Koordinatorëve Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë, ka administruar dhe kryer veprime verifikimi për 21 raste të reja ankesash dhe denoncimesh për korrupsion, gjatë muajit prill 2023. Veprimtaria e institucioneve si Agjencia Shtetërore e Kadastrës (drejtoritë vendore të saj), Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor etj, janë kontrolluar nga inspektorët dhe koordinatorët antikorrupsion mbështetur në ankesa dhe denoncime të ardhura në rrugë zyrtare me shkrim (12 raste) dhe në adresën elektronike (9 raste). Dy prej rasteve të regjistruara janë përcjellë përmes platformës së bashkëqeverisjes, [www.shqiperiqageduam.al](http://www.shqiperiqageduam.al). Pas verifikimeve të kryera janë gjetur shkelje dhe janë përfunduar plotësisht 4 raporte përfundimtare, përmes të cilave është propozuar 1 kallëzim penal për dy persona ku një është ish-titullar, për dyshime të arsyeshme të veprës penale të shpërdorimit të detyrës (neni 248/Kodi Penal), 2 masa për "largim nga detyra", 2 masa për fillim të ecurisë disiplinore si dhe 17 rekomandime. Problematika e pronave dhe moskryerja e procedurave sipas ligjit dhe rregullave të procedurës vijon të mbetet edhe për këtë muaj sektori më vulnerabël dhe që ka marrë vëmendje të shtuar nga Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion.

Denonconi raste dhe praktika abuzive në: [koordinatoriak@drejtesia.gov.al](mailto:koordinatoriak@drejtesia.gov.al)

#### Ngrihet sistemi elektronik për menaxhimin e denoncimeve të rasteve korruptive pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit

**01-28.04.2023:** Ministria e Drejtësisë është në fazën përfundimtare të zhvillimit të një sistemi elektronik për menaxhimin e denoncimeve mbi rekordet korruptive. Ky sistem do të mundësojë menaxhimin dhe përpunimin e të gjitha informacioneve të lidhura me denoncimet dhe rekordet korruptive, duke nisur nga denoncimet e qytetarëve dhe të bizneseve, deri në zgjidhjen përfundimtare të tyre. Sistemi do të ndërveprojë me platformën unike qeveritare e-Albania, dhe që ka për qëllim të përmirësojë komunikimin midis qytetarëve dhe institucioneve publike. Në këtë sistem do të jenë të përfshira edhe disa institucione të rëndësishme, siç janë Qendra Kombëtare e Biznesit dhe sistemi i tatimeve. Kjo do të mundësojë bashkëpunimin midis këtyre institucioneve dhe administratës publike në luftën kundër korrupsionit dhe në përmirësimin e efikasitetit të proceseve të biznesit. Gjithashtu, SPAK dhe prokuroritë e rretheve do të lidhen me këtë sistem, duke mundësuar një bashkëpunim të ngushtë midis institucioneve publike në luftën kundër korrupsionit dhe në zbatimin e drejtësisë në mënyrë më efektive. Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Denoncimeve mbi Rekordet Korruptive është një hap i rëndësishëm përpara në luftën kundër korrupsionit dhe në përmirësimin e qeverisjes së hapur përmes digjitalizimit. Ministria e Drejtësisë nëpërmjet këtij mekanizmi, do të rrisë transparencën, përmirësojë në kohë reale të dhënat e luftës kundër korrupsionit, të sistemit të drejtësisë dhe të përfshirjes institucionale, si një tregues për të përmirësuar shërbimet publike dhe menaxhimin e burimeve publike, dhe për të siguruar një qeverisje më efikase dhe më transparente në interes të qytetarëve dhe shtetit të së drejtës.



#### Ministria e Drejtësisë drejton institucionet në përgatitje të fazës II të vlerësimit, të Raundit V në GRECO

**4.04.2023:** Ministria e Drejtësisë, kreu i delegacionit të qeverisë shqiptare në GRECO ka filluar përgatitjet për hartimin dhe koordinimin e masave zbatuese të rekomandimeve të lëna në kuadër të Raundit V të Vlerësimit: *Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në qeverinë qendrore (funksionet e larta ekzekutive) dhe agjencitë e zbatimit të ligjit*, të GRECO. Pas përfundimit të fazës 1 të vlerësimit, Shqipëria mori një vlerësim pozitiv për transparencën e institucioneve qendrore, kontrollin e pasurive dhe të interesave private të zyrtarëve, ecurinë progresive të integritetit në strukturat e Policisë së Shtetit dhe të funksionimit të plotë të SPAK. Vlerësimi u krye në seancën plenare të 29 nëntorit 2022, dhe me dërgimin e raportit të përputhshmërisë për Shqipërinë, tashmë ka filluar programimi i ndërhyrjeve për rekomandimet e mbetura. Autoritetet publike me kompetenca parandaluese të korrupsionit dhe Policia e Shtetit duhet të thellojnë masat dhe ndërhyrjet për çështje si zbatimin e planeve të integritetit, verifikimi i shtuar për të shmangur konflikte interesi në raste të vendimmarrjes në nivel politik, konsultim publik të shtuar në fushën legislative, si dhe me shumë qëndrueshmëri në detyrë të zyrtarëve të lartë të policisë. Qeveria shqiptare do të raportojë në GRECO në qershor 2024.

Raporti i Përputhshmërisë për Shqipërinë, faza 1, gjendet i publikuar në link: <https://www.drejtesia.gov.al/publikime-3/>



## Masat antikorrupsion kryesojnë komponentët e Planit Kombëtar për Partneritet për Qeverisje të Hapur, 2023-2025

**27.04.2023:** Qeveria shqiptare, rikonfirmon angazhimin në Partneritetin e Qeverisjes së Hapur (OGP), duke miratuar Planin e ri Kombëtar për Qeverisje të Hapur, 2023-2025. Plani Kombëtar i Veprimit mbështet dhe promovon parimet e transparencës, përfshirjes institucionale dhe llogaridhënies në gjithë nivelet e administratës publike duke planifikuar masa dhe veprime me bazë partneritetin me organizatat e shoqërisë civile. Komponenti Antikorrupsion i çel planin e masave për tre vitet në vijim me objektivat kryesore: *Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit.* Gjatë muajve janar-mars 2023 u zhvillua për këtë qëllim një proces i hapur bashkë-hartimi i planit masash me organizatat e shoqërisë civile. Ndërgjegjësimi i publikut të gjerë kundër korrupsionit (I), Edukimi i publikut të gjerë kundër korrupsionit (II) dhe Edukimi i administratës publike mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit (III) janë tre rezultatet e pritshme për të cilat janë planifikuar 14 masa. Komunikim dhe vizibilitet, forcim të mekanizmave të integritetit, informim i shtuar antikorrupsion, metodologji dhe mjete hetimi kundër korrupsionit, profesionistë me kapacitete të rritura të fushës janë 'produktet' e këtij plani veprimi, dhe të pritshme për zbatim në vitet 2023-2024-2025, në këtë angazhim. Plani Kombëtar i Veprimit për Partneritet për Qeverisje të Hapur u miratua nga Komiteti Shumë-Palësh i Këshillimit Kombëtar për Qeverisje të Hapur, në unanimitet me përfaqësues nga akademia, sektori privat dhe shoqëria civile.

Njihuni me planin e ri të veprimit në link: <https://www.drejtësia.gov.al/dokumente-strategjike/>



## Shqipëria nënshkruan Zotimin e Transparencës për rishikimin e Konventës së OKB-së kundër Korrupsionit

**24.04.2023:** Shqipëria nënshkroi marrëveshjen e Zotimit të Transparencës (*Transparency Pledge*) me Koalicionin e Organizatave të Shoqërisë Civile pranë UNCAC duke garantuar më shumë transparencë, bashkëpunim dhe bashkë-bërje të politikave antikorrupsion. Ministri i Drejtësisë në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit ka nënshkruar Zotimin e Transparencës, një proces ky që i paraprin edhe vlerësimin në kuadër të ciklit të dytë të vlerësimit të zbatimit të Konventës së OKB-së kundër Korrupsionit (UNCAC). Në këtë mënyrë, shteti shqiptar riafirmon rëndësinë e transparencës dhe të konsultimit publik në adresimin e korrupsionit, duke kërkuar në këtë mënyrë që edhe shoqëria civile të mund të luajë një rol vendimtar për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në vend. Me këtë nënshkrim, thellohet bashkëpunimi me shoqërinë civile duke ofruar mundësi pjesëmarrjeje të shoqërisë civile jo vetëm në konsultimin e akteve ligjore dhe nënligjore, të nismave të politikëbërjes, por edhe për vlerësimin e zbatimit të tyre apo edhe për të marrë iniciativë më efektive. Nismat e bashkëpunimit në fushën antikorrupsion, koalicionet e deritanishme qeveri-shoqëri civile tashmë kanë një dritare më shumë bashkëpunimi. Me nënshkrimin e Zotimit të Transparencës, Shqipëria u bë vendi i 34 në botë që e nënshkruan këtë angazhim. Informacioni i plotë për ciklet e vlerësimit të Shqipërisë për zbatimin e Konventës së OKB-së, raportet e vlerësimit dhe të tjera informacione mund të gjendet të plota në profilin e vendit.

Merrni më shumë informacion në: [Transparency Pledge Compliance map](#) dhe [blog post](#).

